



KËSHILLI I FSHATIT STUBËLL E EPËRME Stubëll e Epërme, janar 2010

PËR PLANIN ZHVILLIMOR – URBAN TË KOMUNËS SË VITISË PLANI ZHVILLIMOR - URBAN I FSHATIT STUBËLL E EPËRME

Si e shohim Stubllën në të ardhmen?

Stublla, një fshat me rreth 3500 banorë, prej të cilëve mbi 2800 janë të shpërndarë gjithandej nëpër Evropë e Amerikë. Jeta e rëndë, mungesa e punësimit kanë bërë që stubllasit të krijojnë “kolonitë” e tyre nëpër disa shtete evropiane, si në: Itali, Zvicër, Gjermani, Austri e gjetiu. Por, janë të njëjtit qytetarë që kanë investuar në të gjitha projektet e Stubllës; rrugët, shkolla, ambulanca, qendra rinore (salla sportive, një sallë për aktivitete të ndryshme dhe një kuzhinë), një pjesë e ndriçimit të rrugëve të fshatit e parku janë gati 100% investim i qytetarëve të Stubllës.

Përkundër kësaj, çka i duhet ende Stubllës?

Infrastruktura

I. Rrugët - Stublla ka të asfaltuara të gjitha rrugët, edhe ato nëpër lagje, që konsiderohen si rrugë dytësore, por që është e pashmangshme zgjerimi i tyre, që nga hyrja në Stubëll përgjatë tërë rrugëve kryesore. Rruga nga aksi rrugor Viti-Letnicë që kthen e të shpie për në Stubëll deri të Kisha e Re është asfaltuar në vitin 1985 dhe tashmë ajo është shumë e dëmtuar. Gjithashtu, kjo pjesë e rrugës me gjatësi prej mbi 2 km është tejet e rrezikshme për stinën e dimrit dhe jo rrallë vështirë për t’u kaluar meqë si zakonisht mungon edhe mirëmbajtja dimërore e saj nga ana e mekanizmave gjegjës institucional-komunal. Qytetarët vetë kujdesën për rrugën e tyre dhe të shumtën vetë e pastrojnë gjatë dimrit. Kur të kihen parasysh të gjitha këto, pra nevoja e asfaltit të ri, intervenimi për korrigjimin e rrugës si dhe rreziku permanent për shkak të pjerrtësisë së madhe, **kërkesë** e qytetarëve të Stubllës është **HAPJA E RRUGËS SË RE** në drejtimin: **rruga e Kolpingut** që përfundon në aksin rrugor Letnicë – Viti, tek vendi, siç njihet nga populli, “**përroi i magjupit**” ose tek “**përroi i shillocit**”. Kjo rrugë del krejt e rrafshët, i ekspozohet gjithnjë diellit dhe nuk është me e gjatë se **1,6 km, duke shkurtuar distancën nga Vitia për diku 2 km**. Kjo rrugë hap mundësinë e zgjerimit të fshatit përgjatë kësaj rruge meqë lidhë shumë prona të syubllasve.

Po ashtu, **Stublla ka nevojë** edhe për **hapje të rrugëve të tjera brenda vetë fshatit** dhe atë:

1. nga shtëpia e Gjergjit Nocit (lagja e Koliqëve) deri të ambulanca;
2. nga struzhi tek rruga e lagjes së Munishëve (Puturëve);
3. nga Kisha e Vjetër – Muzeu Kombëtar i Shkollës së Parë Shqipe në Kosovë deri në rrugën kryesore të lagjes së Koliqëve dhe më tutje në drejtimin që do lidhte me rrugën (që pretendohet të hapet) nga shtëpia e Gjergjit Nocit- ambulanca.

Edhe këto rrugica të reja mundësojnë për shtrirje të re të Stubllës, por në të njëjtën kohë ndihmojnë edhe në shfrytëzimin e tokës bujqësore.

Rruga Stubëll – Zhegër...

Veç rrugës kryesore në drejtim të Vitisë dhe rrugicave të reja brenda fshatit, me insistimin e Stubllës dhe në bashkëpunim edhe me qytetarë të Selishtës e të Godenit të Madh (fshatra të komunës së Gjilanit) dhe në pajtueshmëri me institucionet komunale të Vitisë e të Gjilanit, është hartuar projekti Stubëll – Selishtë – Goden i Madh – Zhegër (në afërsi). Kjo rrugë pos që lidhë Stubllën (dhe Vitinë) me magjistralen Gjilan – Kumanovë, Stubllën e afron me Gjilan në 18 km (dhe jo si gjer me tani 35 km). Veç kësaj , kjo rrugë hap mundësi të mira për komunikim të biznesit, për investime në bujqësi (blegtori edhe në ngritjen e shtallave, bletari, pemëtari), hotelieri e qendra rekreative – sportive, qendra rehabilituese etj. Me këtë rrugë Stublla fiton edhe një hyrje-dalje të re, duke mos mbetur “zonë qorre”. Kjo rrugë do ndikojë tek të rinjtë për studime, meqë Gjilani është qytet universitar. Do thënë se në vitin 2003 është prerë shiriti për fillimin e punëve të kësaj rruge, ndërkohë që tek tash duket se Komuna e Vitisë, por edhe niveli qendror, Minsitria e Trasnportit po e shqyrtojnë më seriozisht realizimin e këtij projekti.

I.1. NDRICIMI PUBLIK I RRUGËVE

Stublla veç ka bërë një pjesë të mirë të ndriçimit publik të rrugës kryesore dhe atë nga hyrja në Stubëll deri tek shtëpia e Gjon D.Ukaj (mbi kishë të re). Mbetet që në të ardhmen me një mbështetje të komunës ky projekt të përfundojë i tëri, që nënkupton përgjatë rrugës në drejtim të struzhit deri të Muzeu Kombëtar i Shkollës së Parë Shqipe në Kosovë dhe përgjatë rrugës Atë Franë Koliqi që shpie në lagjen Koliq e më tej në lagjen Ballaban.

II. MUZEU KOMBËTAR I SHKOLLËS SË PARË SHQIPE NË KOSOVË – DOMOSDOSHMËRI NGRITJA E NJË OBJEKTI TË RI

Stublla ka Muzeun e Shkollës së Parë Shqipe në Kosovë dhe në çdo fund shtatori, që nga viti 1990 mbahet manifestimi gjithëkombëtar kulturor, shkencor, letrar... "Takimet Don Mikelit", i cili përcillet me interesim të madh edhe nga mediat dhe me botimin e buletinit të manifestimit. Objekti ekzistues nuk i përmbush nevojat e një muzeu, prandaj **është domosdoshmëri ndërtimi i një objekti ndihmës të Muzeut**. Shih për këtë është duke u hartuar projekti i një objekti që do ketë gjithë infrastrukturën e nevojshme: hapësirën për ruajtjen dhe ekspozimin e eksponateve të ndryshme: zyrat për stafin e muzeut në të ardhmen, bibliotekën, hapësirën për lexim, sallën për manifestim (së paku me 200 ulëse) etj.etj.

Po ashtu, në oborrin e Muzeut do ngrrihet dhe pllaka përkujtimore e martirëve dhe ato falenderuese për Francën, Anglinë e Austrinë.

III. RESTAURIMI DHE KONSERVIMI I SHTËPISË SË VËLLEZËRVE ZEFI

Pranë Muzeut Kombëtar të Shkollës së Parë Shqipe është ndërtesa, shtëpia e vëllezërve Zefi, familje kjo e vrarë nga partizanët e komunistët për aktivitetin e tyre kombëtar. Pasardhësit e tyre që u persekutuan nga pushteti u detyruan të shpërnguleshin nga Stublla në vende të ndryshme. Engjëll Zefi, normalist i Shkodrës, më urdhër të Ernest Koliqit, atëbotë Ministër i Arsimit të Shqipërisë, që dërguar për mësues në Kosovë dhe është pikërisht ky që hapi shkollën e parë shqipe në komunën e Ferizajit, në Fshatin e Vjetër. Ishte edhe krijues. U vra nga komunistët, më 1946 në Stubëll, siç qenë vrarë më parë edhe vëllezërit Pali, në Talinoc të Ferizajit, në luftë me partizanët dhe Luku me të birin Ndoun, të vrarë brenda në shtëpinë e tyre në Stubëll. Gjithnjë pse ishin kundër ndarjes së Kosovës nga Shqipëria dhe në vazhdimësi po i bënë rezistencë forcave ta armatosura të ish Jugosllavisë.

Kjo shtëpi, në vitet '50-'60 të shek. XX, ka shërbyer edhe si ambulancë e fshatit. Shtëpia do duhej të restaurohej jo vetëm për hir të aktivitetit kombëtar të vëllezërve Zefi, të cilët do duhej të shpalleshin heronj të kombit, por edhe për karakteristikat dhe vlerat arkitektonike që ka.

IV. KONSERVIMI I VARREZAVE TË FSHATIT – HULUMTIMI ARKEOLOGJIK I PJESËS KU KA EKZISTUAR-FUNKSIONUAR KOLEGJI I SHËN LUKËS, 1584

Është më se e nevojshme hulumtimi arkeologjik i hapësirës tek varrezat e sotme të fshatit ku mendohet të ketë ekzistuar Kolegji i Shën Lukës, në vitin 1584. Dhe për këtë konsiderojmë që ka prova të mjaftueshme, për çka është shkruar shpeshherë. Po ashtu, konsiderojmë se është e nevojshme edhe konservimi i këtyre varrezave përsëri, si në vijim:

1. janë varre të shumta që për shkak të rrethanave historike, robërisë nën Perandorinë Otomane, në vend të kryqit si rëndom, kanë kryqin prej guri te

- futur nën dhe deri në krahë, për të dhënë përshtypjen se janë gur dhe jo kryqe. Kjo dëshmon për gjendjen e stubllasve nën okupimin otoman.
2. Po ashtu aty ka dhe varre të martirëve të cilët u kthyen gjallë nga depërtimi në Muhaliq (1846-1848).
 3. i një rëndësie të veçantë është edhe varri i Dokut (Dokës). Ai, para se të depërtohej, gdhendi vetë kryqin prej guri, meqë ishte i bindur se në dheun e largët të Perandorisë Otomane, pranë varrit të tij nuk do i vënin kryqin, shenjë të përkatësisë së besimit dhe identitetit të tij. Ai kthehet i gjallë falë ndërhyrjes së fuqive të mëdha të kohës, Francës, Anglisë etj. dhe sot mbi varrin e tij është kryqi që vetë kishte gdhendur.

V. AMFITETARI VEROR

Stubllavaqa (kodra) ofron mundësi të mëdha atraktiviteti. Është më se e arsyeshme ndërtimi i një amfiteatri veror në Stubllavaqë, në rrënjë të saj, tek vendi i quajtur **Varri i Don Nikollës**, i cili nuk do të kërkonte ndonjë kosto të madhe, ndërkaq që do mundësonte mbajtjen e manifestimeve të shumta kulturore e letrare (Orën e Madhe Letrare e programin argëtues – kulturor, në manifestimin “Takimet e Don Mikelit”, kur dihet pjesëmarrje e mijëra vetëve në këtë manifestim e për organizimi të tjera).

VI. NGRITJA NJË PËRMENDOREJE PËR DON NIKOLLA SHARBANOV DHE DON NIKOLLË MAZREKU

Janë këta dy priftërinj që në shekullin e kaluar kishin shërbyer në Stubëll. Jo rrallë, në mungesë të një kishë mesha ishte kremtuar, celebruar në ambient të hapur dhe atë në kodrën Stubllavaqa, ku dhe ishin varrosur. Diku në vitet '90 të shek. të kaluar eshtrat e tyre u rivarrosën në varrezat pranë Kishës së Re. Konsiderojmë që sot eshtrat duhet të kthehen aty ku ishin varrosur në fillim,. Aty të ngritet edhe një përmendore për ta. Kjo do hapte edhe një komunikim në të ardhmen me Rumaninë, meqë Don Nikolla Sharbanov ishte nga Rumania. Ky hap, krijon mundësinë për një komunikim kulturor me Rumaninë në të ardhmen.

VII. UDHA E KRYQIT

VII.1. Kryqi - në majë të Stubllavaqës është i vendosur që në vitin 1905, vit ky, kur Stublla u shpall famulli më vete dhe i vendosur nga famullitari dhe mësuesi i Shkollës së Parë Legale Shqipe, Don Mikel Tarabulluzi. **Ky kryq është e arsyeshme dhe e nevojshme të konservohet.**

VII.2. Kapela - është që një vendim i mëhershëm i Këshillit dhe i qytetarëve të Stubllës ndërtimi i një kapele-kishëze të vogël pranë Kryqit në majë të stubllavaqës. Me këtë kapelë do përfundonte projekti i Udhës së Kryqit.

VII.3. Projekti i Udhës së Kryqit – Gjatë kohës së kreshmëve – koha para festës së Pashkëve, Stublla karakterizohet nga përkujtimi i mundimeve dhe i kryqëzimit të Krishtit në Golgota, përmes kremtimit të Udhës së Kryqit. Është i vetmi rast në Kosovë dhe që vijnë me qindra e qindra njerëz nga e tërë Kosova dhe nga jashtë.

Shih për këtë, stubllasit kanë hartuar projektin e Udhës së Kryqit, jo vetëm për karakterin religjioz, por një projekt i tillë do konsiderohej edhe si një monument kulture. Projekti që kap një kosto prej 65.000 euro (gjashtëdhjetë e pesë mijë euro), ka filluar së realizuari, por jo në përmasën e projektit për shkak të mungesës së fondeve, prandaj dhe realizimi i projektit çfarë është sot, konsiderohet i përkohshëm.

Këto projekte në stubllavaqë nxisin nevojën e ndërtimit të një **restoranti a moteli në stubllavaqë, në veri të saj, jo larg Udhës së Kryqit.**

VIII. PORTAT

Stublla ka në projekt për të ardhmen edhe ndërtimin e portave. Portat do ndërtohen në hyrje të Stubllës dhe përgjatë rrugës kryesore, në vende të përshtatshme. Në porta do ketë dhe mbishkrime, citate edhe nga Librat e Shenjtë, të të gjitha religjioneve dhe nga kultura të ndryshme. Kjo, për arsyen që kushdo që viziton Stubllën të ketë mundësinë të gjejë edhe një pjesë të vetvetes, meqë Stublla vizitohet nga vizitorë të cilët vijnë po thuaj nga të gjitha kontinentet.

IX. PJESA PËR QENDRA REKREATIVE...

Zona, që ne e quajmë gjolltë dhe tek antena, është një natyrë e mrekullueshme dhe e virgjër për hotelieri, për ndërtimin e qendrave rekreative, rehabilituese etj. Kjo zonë do duhej të parashihej pikërisht për projektet si këto.

Të gjitha këto që u cekën më lart, hapin mundësi të mira që Stublla ta sendërtojë të ardhmen mbi bazë të projekteve kulturore.

X. UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI

Stubllasit vazhdimisht bëjnë përpjekje për të gjetur një zgjidhje për realizimin e projektit të ujësjellësit dhe të kanalizimit. Një zgjidhje për ujësjellës, ujë të pijshëm do të ishte lidhja me ujësjellësin Letnicë - Viti ose përmes sistemit të shpimit.

Stubllasit janë të gatshëm për investim edhe për këto projekte, madje janë dhe shumë të përkushtuar.

XI. ZONA PËR BIZNESE

Preferohet edhe një zonë për hapje të bizneseve. Një hapësirë e tillë do ishte pjesa e njohur si Kroji i therrave, pjesa përgjatë aksit rrugor Stubëll – Viti dhe përgjatë rrugës nga lagjja Koliq në drejtim të vendit të quajtur Rakoc. Kjo e fundit mbase do ishte e përshtatshme edhe për hapje të shtallave.

XII. EDUKIMI DHE SHËNDETËSIA

Stublla ka shkollën fillore, të rinovuar nga vetë qytetarët e Stubllës, gjatë vitit 2009. Po ashtu ka dhe ambulancën më së të mirë, të ndërtuar me investim të stubllasëve. Edhe qendra rinore, sportive si dhe parku i fshatit janë investime të qytetarëve të Stubllës.

XIII. DEPONIA E MBETURINAVE

Stublla ka formën e vet të organizmit për mbledhjen dhe deponinë e mbeturinave. Patjetër që deponia e egër nuk është zgjidhje, por detyrim për stubllasit. Do duhej një ndërhyrje dhe zgjidhje institucionale për këtë çështje.

PËRFUNDIM

Stublla, mbi bazën e projekteve të parapara do krijojë hartën e vet kulturore dhe si e tillë do meritonte të hynte në të ashtuquajturat **zona të interesit të veçantë**, jo vetëm për komunën e Vitisë. Kjo më pas do hapte rrugë për investime dhe për thithje të fondeve të ndryshme dhe për një zhvillim të përgjithshëm që këtë vendbanim do ta qonte drejt një zone të mirëfilltë urbane.

Për Këshillin e Stubllës

Sarë **GJERGJI**